



NATIONAL
YOUTH
CONGRESS



Hanns
Seidel
Stiftung

Raport mbi Strukturën e Qeverisë së Nxënësve
Në kuadër të implementimit të projektit

**“YOUTH AND DEMOCRACY –
AKTIVIZMI I TË RINJVE NË SHKOLLË,
KOHA PËR NJË NARRATIVË TË RE”**

Autorë:


Dafina Peci

|

Enxhi Lipa

|

Ili Gërdupi



Ky botim u realizua me mbështetjen e
Fondacionit Gjerman Hanns Seidel Opinionet, gjetjet,
përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve
dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel.
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet,
shumëfishohet dhe shpërndalet duke përdorur sistemet elektronike,
pa lejen me shkrim të Kongresit Rinor Kombëtar dhe Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel,
përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me
parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit.
Përdorimi komercial i këtij publikimi nuk është i lejuar.

Analiza e të dhënave

Duke qenë se strukturat e Qeverisë së Nxënësve janë një nga strukturat më të rëndësishme lidhur me procesin e vendimarrjes në shkollë, Kongresi Rinor Kombëtar ka vendosur që gjatë këtij viti ti kushtojë një rëndësi të veçantë rolit, funksionimit, problematikave dhe nevojave të këtyre strukturave. Me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Hanns Seidel Stiftung, në kuadër të një programi 3 vjeçar KRK po zbaton iniciativën “Manuali mbi Qytetarinë Aktive “Youth and DemocraCity”-Aktivizimi i të rinjve në shkollë, koha për një narrativë të re”.

Në kuadër të kësaj iniciative është zhvilluar një pyetësor i cili është i ndarë në 5 sesione kryesore dhe synon të identifikojë perceptimin e të rinjve mbi situatën aktuale të Qeverisë së Nxënësve dhe të integrojë aspiratat dhe sygjerimet e tyre mbi mirëfunksionimin e këtyre strukturave duke ndërmarrë iniciativa dhe aksione konkrete.


Kampionimi

Pyetësori i zhvilluar është shpërndarë tek të rinjtë në 12 qarqe të Shqipërisë dhe numri në total i të anketuarve është 259 të rinj të cilët i përkasin grupmoshave dhe zonave gjeografike të ndryshme. Zgjedhja e kampionit është zhvilluar në mënyrë të rastësishme dhe shpërndarja e pyetësorit u zhvillua online. Pyetësori përmban në total 31 pyetje duke ndërthurur pyetje të mbyllura dhe të hapura të cilat janë adresuar me qëllim përmbushjen e objektivave dhe marrjen e të dhënave për t’ju përgjigjur çështjeve që ky raport ngre. Të dhënat e përpunuara nga ky pyetësor janë si cilësore ashtu edhe sasore të cilat janë paraqitur në raport edhe me nga ana vizuale me anë të grafikëve.

Ndonëse Kongresi Rinor Kombëtar ka zhvilluar një shpërndarje të barabartë të këtij pyetësori, nga pikëpamja gjinore rezulton se femrat kanë pjesëmarrje më të lartë se meshkujt. Nga përgjigjet e të anketuarve rezulton se 60,2% e tyre janë femra dhe 39,8% janë meshkuj.

Gjinia


259 risposte



Nga pikëpamja e grupmoshave ky pyetësor ka pasur targetin kryesor tek të rinjtë e moshës 14-22 vjeç, pra të rinjtë që janë ende në shkollë, kryesisht në ciklin e mesëm të ulët (9 vjeçar), të mesëm të lartë (gjimnaze) dhe në ciklin e lartë (universitete) të cilët janë të angazhuar pranë strukturave të Qeverive të Nxënësve.

Mosha

259 risposte




Në bazë të rezultateve më shumë se gjysma e të anketuarve, përkatësisht 57,1% i përkasin grupmoshës 14-16 vjeç. Siç paraqitet edhe në grafik pjesa e mbetur, pra 35,9% i përket grupmoshës 17-19 vjeç dhe 6,9% moshës mbi 19 vjeç.

Ndonëse strukturat e Qeverive të Nxënësve kanë dinamika dhe zhvillime të ndryshme në cikle të ndryshme studimi, rëndësia e tyre mbetet thelbësore në marrëdhënien student-staf pedagogjik. Roli i qeverive të nxënësve përveç përfshirjes së studentëve në proceset e vendimarrjes në shkolla i kalon kufinj të institucioneve arsimore pasi rëndësia e tyre është shumë e vlefshme në hartimin e politikave arsimore, përmirësimin e kurrikulave dhe cilësisë së arsimit nëpër shkolla dhe rigjallërimin e jetës sociale, artistike, kulturore brenda dhe jashtë edukimit formal.

Cikli që aktualisht ndiqni:

259 risposte


Nga të dhënat rezulton se 62,5% e të rinjve në fakt u përkasin arsimit të mesëm të lartë pra gjimnazeve, ndërkohë që 29,7% e të rinjve që i janë përgjigjur pozitivisht pyetësorit i përkasin arsimit të mesëm të ulët (9-vjeçar) dhe vetëm 7,7% e tyre arsimit të lartë universitar.



Duke qenë se shpërndarja e pyetësorit është bërë në 12 qarqe të Shqipërisë shpërndarja gjeografike e të rinjve është e larmishme. Nga të dhënat rezulton se: 40,4% e tyre i përkasin qarkut Berat, 33,3% qarkut Elbasan, 16,2% qarkut Lezhë, 4% qarkut Shkodër dhe 3,5% qarkut Durrës. Pjesa e mbetur është e shpërndarë në qarqet e tjera përkatësisht: 1% Fier, 0,5% Gjirokastrë, 0,5% Tiranë dhe 0,5% Dibër.

Aktualisht ndiqni?

259 risposte




Struktura e Qeverive të Nxenesve është një strukturë që synon gjithëpërfshirjen dhe aktivizimin e të rinjve në të gjitha institucionet arsimore qofshin ato publike apo private. Megjithëate nga 259 të anketuar, 96,1% e tyre vijnë nga shkolla publike dhe vetëm 3,9% nga shkolla private.

Duke qenë se shpërndarja e pyetësorit është bërë në 12 qarqe të Shqipërisë shpërndarja gjeografike e të rinjve është e larmishme. Nga të dhënat rezulton se: 40,4% e tyre i përkasin qarkut Berat, 33,3% qarkut Elbasan, 16,2% qarkut Lezhë, 4% qarkut Shkodër dhe 3,5% qarkut Durrës. Pjesa e mbetur është e shpërndarë në qarqet e tjera përkatësisht: 1% Fier, 0,5% Gjirokastrë, 0,5% Tiranë dhe 0,5% Dibër.

Shkolla juaj është në:


259 risposte



Një tjetër komponent përbërës i pyetësorit ka qenë edhe statusi i të rinjve. Ata janë kategorizuar në katër statuse të ndryshme dhe nga të dhënat rezulton se 59,8% e të rinjve pjesë e këtij raporti janë aktualisht nxënës, 10,8% e tyre kanë qenë anëtarë të qeverive të nxënësve; 24,3% janë aktualisht anëtarë të qeverive të nxënësve dhe 5% e tyre kanë qenë ish nxënës.

Aktualisht jeni?


259 risposte



Gjatë ciklit tre vjeçar mbi qytetarinë aktive Kongresi Rinor Kombëtar ka mobilizuar rreth 1500 të rinj në të gjithë Shqipërinë. Gjatë 2020 KRK ka zhvilluar gjashtë trajnime fizike dhe takime online nëpërmjet platëformës Zoom duke u dhënë mundësinë e angazhimit shumë të rinjve që vijnë nga zona dhe kategori të ndryshme. Megjithatë gjatë kësaj ankete janë bërë pjesë 259 të rinj nga ku 27,8% e tyre janë aktivë dhe të angazhuar pranë organizatave jo-fitimprurëse. Pjesë e kësaj ankete janë bërë edhe një numër i lartë të rinjsh jo aktivistë dhe që nuk kanë qenë pjesë e programit gjatë tre viteve. Nga të rinjtë 68,3% shprehen se nuk u përkasin asnjë kategorie ndërkohë që 3,9% janë angazhuar si alumni pranë programit mbi qytetarinë aktive gjatë tre viteve.

Cilës kategori i përkisni?


259 risposte



Gjatë tre viteve KRK ka zvjilluar 30 trajnime me të rinjtë në kuadër të programit mbi qytetarinë aktive duke ngritur kapacitete, duke zhvilluar aftësitë e tyre dhe duke krijuar hapsira të përbashkëta ndërveprimi. Megjithate nga sondazhi rezulton se 77,2% e të rinjve nuk kanë qenë pjesë në takimet e zhvilluara më parë nga Kongresi Rinor Kombëtar ndërkohë që 22,8% po. Ky rezultat tregon nevojën e lartë që të rinjtë kanë për tu angazhuar dhe aktivizuar në nivel lokal. Ky rezultat është gjithashtu një vlerë e shtuar e iniciativës pasi tregon numrin e lartë të prurjeve të reja dhe diversitetin midis të rinjve.

A keni qenë pjesë e trajnimeve të zhvilluara më parë nga Kongresi Rinor Kombëtar?


259 risposte



Në takimet e kryera një rëndësi e veçantë i është kushtuar Qeverive të Nxënësve. Nga të dhënat shihet se 57,9% e të rinjve kanë qenë edhe më parë pjesë e takimeve që lidhen e strukturën e qeverive të nxënësve, kurse 42,1% e tyre jo.

A keni qenë pjesë e takimeve që lidhet me strukturën e Qeverisë së Nxënësve?

259 risposte




Perceptimi mbi situatën aktuale

Për të bërë një analizë të mirëfilltë mbi situatën e Qeverive të Nxënësve është shumë e rëndësishme të integrojmë opinionin e të rinjve mbi gjendjen aktuale. Nga të anketuarit 89,6% shprehen se Qeveria e Nxënësve është pjesë e shkollës së tyre ndërkohë që 10,4% thonë jo.

A ekziston struktura e Qeverisë së Nxënësve (QN) në shkollën tuaj?


259 risposte



Komponenti tjetër i pyetësorit është ai që lidhet me nivelin e njohurive të nxënësve mbi kuadrin ligjor që rregullon strukturën e Qeverisë së Nxënësve. Nga përpunimi i të dhënave rezulton se 12,4% e të anketuarve janë shumë të informuar mbi dispozitat ligjore që rregullojnë strukturat e Qeverisë së Nxënësve në shkolla. Ata që shprehen se kanë mjaftueshëm njohuri përbëjnë 24,7% të të anketuarve ndërkohë që personat që shprehen se nuk janë shumë të informuar përbëjnë 32% të tyre.

A keni njohuri mbi kornizën ligjore të strukturës së QN?

259 risposte



Ndërmjet të rinjve ka edhe persona të cilët nuk kanë aspak njohuri mbi anën ligjore dhe aktet që rregullojnë funksionimin dhe implementimin e Qeverve të Nxënësve. Këta të rinj përbëjnë 10,8% e të anketuarve ndërkohë që 20,1% janë përgjigjur duke zgjedhur opsionin “Nuk e di”.


Mirëfungsioni dhe implementimi i akteve nënligjore është pika kyçe që u mundëson të rinjve ushtrimin e një nga funksioneve kryesore të Qeverisë së Nxënësve që është përfshirja e të rinjve në vendimarrje. Nga pyetësi 85,7% e të rinjve pohojnë se Qeveritë e Nxënësve pranohen si struktura brenda shkollës ndërkohë që 14,3% e tyre e mohojnë këtë gjë.

Mirëfungsioni dhe implementimi i akteve nënligjore është pika kyçe që u mundëson të rinjve ushtrimin e një nga funksioneve kryesore të Qeverisë së Nxënësve që është përfshirja e të rinjve në vendimarrje. Nga pyetësi 85,7% e të rinjve pohojnë se Qeveritë e Nxënësve pranohen si struktura brenda shkollës ndërkohë që 14,3% e tyre e mohojnë këtë gjë.

Lidhur me përgjegjësinë e aktorëve dhe faktin se kush duhet të angazhohet për të krijuar kushtet për zgjedhjen e Qeverisë së Nxënësve në shkollë, 39,8% e të rinjve deklarojnë se kjo përgjegjësi i takon mësuesit koordinator për Qeverinë e Nxënësve. Ndërkohë 19,7% e tyre shprehen se kjo është detyrë e Ministrisë së Arsimit, 25,9% shprehen se është përgjegjësi e drejtorit të shkollës, 9,3% e delegojnë këtë përgjegjësi tek Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe vetëm 5,4% mendojnë se detyrë i takon mësuesit kujdestar


A pranohet struktura e Qeverisë së Nxënësve si pjesë e qeverisjes shkollore:

259 risposte




Ngritja dhe funksionimi i Qeverisë së Nxënësve është dëshirë apo detyrim institucional:

259 risposte



Kush duhet të krijojë kushtet për zgjedhjen e Qeverisë së Nxënësve në shkollë:

259 risposte



Mirëfunksionimi dhe implementimi i akteve nënligjore është pika kyçe që u mundëson të rinjve ushtrimin e një nga funksioneve kryesore të Qeverisë së Nxënësve që është përfshirja e të rinjve në vendimarrje. Nga pyetësi 85,7% e të rinjve pohojnë se Qeveritë e Nxënësve pranohen si struktura brenda shkollës ndërkohë që 14,3% e tyre e mohojnë këtë gjë.


Në lidhje me vendimarrjen dhe faktin se kush e thotë fjalën e fundit në vendimet që merr struktura e Qeverisë së Nxënësve, 47,5% e të rinjve shprehen se këto vendime i merr drejtori i shkollës. Nga të anketuarit 17,8% shprehen se fjalën e fundit e thotë kryetari i qeverisë së nxënësve, 12,4% thonë se këtë rol e kryen mësuesi koordinator dhe 11,6% e tyre thonë se vendimet merren nga anëtarët e qeverive të nxënësve. Vetëm 6,9% shprehen se vendimet dhe fjalën e fundit e thonë nxënësit, ndërkohë që 3,9% thonë se fjalën e fundit e ka mësuesi kujdestar.

Një tjetër komponent që është integruar në pyetësor është komponenti i aktivizimit të nxënësve brenda shkollave. Për të matur këtë komponent si dhe llojin e përfshirjes së tyre në vendimarrje në sesionin e dytë të pyetësorit janë hartuar dy pyetje të dedikuara.

Pyetja e parë është rreth nivelit të aktivizimit të të rinjve në shkolla. Nga rezultatet vërehet qartë se 94,6% e të rinjve marrin pjesë në aktivitetet në shkollë përkundrajt 5,4% të cilët janë shprehur negativisht.


Në shkollën tuaj anëtarët e Qeverisë së Nxënësve në klasa janë zgjedhur nga:

259 risposte




Në shkollën tuaj kush e thotë fjalën e fundit në vendimet që merr struktura e Qeverisë së Nxënësve:

259 risposte



A marrin pjesë nxënësit/të rinjtë në aktivitetet në shkollë?

259 risposte



Pyetja e dytë ka të bëjë me nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje. Nga pyetësi, 29,3% e të rinjve shprehen se janë të rriturit ata që vendosin se çfarë duhet të bëhet dhe më pas pyesin nxënësit nëse janë dakort apo jo. 8,5% e tyre shprehen se të rritur janë ata që vendosin, kurse 13,5% e tyre thonë se pasi të rriturit vendosin u lejojnë nxënësve të bëjnë ndryshime të vogla.


Një pjesë tjetër e nxënësve, përkatësisht 17,8% shprehen se të rriturit i marrin idetë dhe propozimet e nxënësve por sërisht vendosin sipas dëshirës së tyre. 25,9% shprehen se të rriturit pasi konsultohen me nxënësit i konsiderojnë mendimet e tyre dhe marrin parasysh të gjitha opinionet e dhëna.

Një pjesë tjetër e të rinjve shprehet se çdo vendim dhe aktivitet kryhet në bashkëpunim midis mësuesve dhe nxënësve. Konkretisht 22% e tyre thonë se të rriturit marrin iniciativën për aktivitete por vendimet merren bashkarisht me nxënësit.

22% e tyre gjithashtu shprehen se nxënësit janë të përfshirë drejtë për drejtë në vendimarrje dhe janë ata që marrin iniciativën për një aktivitet, ndërkohë që të rriturit ndihmojnë. Ndërkohë që 17,8% e tyre shprehen se të nxënësit marrin iniciativën dhe vendosin se çfarë do të bëjnë dhe të rriturit përfshihen vetëm kur nxënësit kërkojnë ndihmë prej tyre.

Në çfarë niveli pjesëmarrjeje janë të përfshirë nxënësit/të rinjtë:

259 risposte



E Ardhmja

Një tjetër sesion i pyetësorit është edhe opinioni i të rinjve lidhur me të ardhmen dhe këndvështrimin e tyre për me një strukturë ideale të Qeverisë së Nxënësve. Ndërmjet opinioneve të të anketuarve ka të rinj që shprehen se struktura e tanishme është shumë e mirë por ajo që duhet rregulluar është implementimi me përpikmëri i të gjitha akteve normative për të siguruar mirëfunksionimin dhe përfaqësimin e të rinjve në mënyrë të denjë në strukturat e Qeverisë së Nxënësve brenda shkollave. Nga përpunimi i të dhënave ka edhe të rinj që preferojnë të mos japin idetë e tyre ose të rinj që nuk kanë informacion mbi këtë çështje.

Megjithatë pjesa më e madhe e të rinjve janë shprehur konstruktiv duke dhënë opinionet e tyre që janë përmbledhur si më poshtë:


- “Një strukturë ideale është ajo që siguron gjithëpërfshirjen e të rinjve dhe marrjen e opinionit të tyre parasysh”
- “Pavarësia e Qeverisë së Nxënësve nga Bordi Drejtues i Shkollës”
- “Të rritet ndikimi i QN në vendimarrje”
- “Autonomia e duhur ligjore dhe administrative duke krijuar oponentë ndaj zyrës drejtuese me qëllim mbarvajtjen e procesit mësimor, sigurinë individuale dhe atë kolektive. Në tërma doktrinarë kjo gjë ekziston por mungon implementimi”
- “Një strukturë ideale do të ishte ajo që siguron meritokraci në marrjen e posteve në QN”
- “Një strukturë ideale është ajo që siguron bashkëpunimin dhe bisedimin nxënës-nxënës dhe nxënës-mësues”
- “Struktura ideale do të përbëhej nga përfaqësues të çdo klase, të zgjedhur nga vetë nxënësit e klasave përkatëse dhe nga anëtarët e bordit të zgjedhur nga vetë senatorët. Secili nga anëtarët duhet të jap idenë e tij dhe më pas kjo ide duhet të shqyrtohet nga mësueset koordinatorë dhe presidenti i shkollës bashkë me zv presidentët në bazë të rregullores së shkollës”
- “Çdo klasë duhet të ketë përfaqësuesin e vet në QN”
- “Një strukturë ideale do të ishte një strukturë me në thelb bashkëpunimin midis nxënësve dhe mësuesve
- “Një strukturë ideale ku pasha e votës duhet të jetë 50% nga nxënësit dhe 50% nga mësuesit”

Nga përgjigjet lidhur me strukturën ideale, shumë të rinj theksojnë faktin se të rinjtë duke qenë pa eksperiencë kanë nevojë për mendimin dhe kontributin e mësuesve dhe stafit pedagogjik.

Qeveria e Nxenesve është një strukturë që rregullohet në bazë të ligjit të arsimit parauniversitar. Pyetur në lidhje me këtë ligj dhe faktin që ai parashikon një nen të përbashkët si për ciklin e mesëm të ulët (9 vjeçar) dhe për atë të mesëm të lartë (gjimnaz), 43,6% e të rinjve u shprehen kundër dhe mendojnë se ky ligj nuk duhet të jetë i njëjtë për të dyja ciklet. Ndërkohë që 56,4% janë dakort dhe pajtohen me ligjin duke shprehur se neni nuk duhet ndryshuar.

Ligji i Arsimit Parauniversitar ka një Nen posaçërisht për strukturën e Qeverisë së Nxënësve. Ky Nen është i përbashkët për ciklin e mesëm të ulët (9-vjeçarin) dhe ciklin e mesëm të lartë. Edhe udhëzimet që dalin lidhur me këtë Nen janë të përbashkëta për të 2 ciklet. Mendon se duhet të jetë i njëjtë si Nen për të 2 Ciklet (i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë)?


259 risposte



Lidhur po me këtë ligj, 48,3% mendojnë se duhet të ketë specifikime për secilin cikël, 24,3% mendojnë se është mirë siç është por duhen marrë masa për implementim dhe 27,4% që duhet të jetë i njëjtë për të dy ciklet.

Në këndvështrimin tuaj si nxënës/i rinj si mendoni ligji duhet:

259 risposte



Pyetur në lidhje me dallimet që kanë strukturat e Qeverisë së Nxënësve midis ciklit të mesëm të ulët dhe ciklit të mesëm të lartë shumë të rinjve shprehen se nuk kanë informacion mbi këtë çështje. Ndërkohë nga dallimet kryesore që ata kanë shprehur janë:

1. Kapaciteti i limituar në vendimarrje: Sipas të anketuarve nxënësit e ciklit të mesëm të ulët për shkak të faktorëve psiko-social që ndikon në aftësinë e tyre për të marrë vendime janë më të limituar në marrjen e vendimeve të duhura dhe kanë nevojë për mbikqyrjen e të rriturve sin ë artikullimin e problemeve ashtu edhe zgjidhjen e tyre.

2. Tematika: Nxënësit e ciklit të mesëm të ulët kanë problematika dhe tematika të ndryshme nga ata të ciklit të mesëm të lartë. Rrjedhimisht ata kanë nevojë për një qasje ndryshe nga ana e stafit pedagogjik për të marrë vendime që janë në të mirën më të lartë të fëmijës.

3. Roli dhe pesha në vendimarrje: Të anketuarit shprehen se të rinjtë e ciklit të mesëm të ulët duhet të kenë më shumë një rol këshillimor pasi pesha e vendimeve që ata marrin nuk mund të jëtë e njëjtë me të rinjtë e ciklit të mesëm të lartë për shkak të moshës së vogël dhe kapacitetit të limituar për të vepruar.

4. Përfaqësimi: Përfaqësuesit dhe anëtarët e zgjedhur në Qeverinë e Nxënësve duhet të paraqesin kërkesat dhe të mbrojnë interesat e shumicës. Për këtë arsye, sipas të rinjve që u janë përgjigjur anketës nxënësit e ciklit të mesëm të ulët kanë më pak gjasa për ta kryer rolin e tyre sic duhet pa u influencuar dhe mbikqyrur nga të rriturit.

Veprimi

Sesioni i fundit i pyetësorit i është kushtuar në mënyrë të veçantë opinionit të të rinjve mbi nisma konkrete që duhen ndërmarrë sipas tyre për përmirësimin e situatës aktuale.

Nga përpunimi i të dhënave sygjërimet e të rinjve janë:

1. Trajnime dhe aktivitete joformale për të rritur kapacitete e të rinjve
2. Gjithëpërfshirja e të rinjve me mundësi më të pakta dhe atyre nga zona rurale

3. Fushata sensibilizuese dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve lidhur me proceset e vendimarrjes
4. Takime me institucionet në nivel qendror dhe lokal: MASR, DAR
5. Takime me të rinjtë lidhur me tematika dhe probleme të grupmoshës së tyre
6. Fushata vizibiliteti dhe promovimi të punës aktuale të QN
7. Përgatitja e materialeve lidhur me problemet kryesore në shkolla
8. Takime dhe mbledhje me drejtues të shkollës dhe mësues koordinatorë
9. Takime të QN me nxënës të tjerë dhe informimi i tyre lidhur me strukturën dhe punën e tyre
10. Takime për të rritur bashkëpunimin midis aktorëve të përfshirë në QN

Pytetur në lidhje me faktin se si mund të përmirësohet roli dhe funksioni i strukturës së Qeverisë së Nxënësve sygjერი më shpeshtë nga të rinjtë ka të bëjë me faktin e forcimit të implementimit të ligjit. Sygjerime të tjera që vijnë nga ana e tyre janë:

1. Duke rritur peshën dhe forcuar zërin e të rinjve në vendimarrje
2. Duke rritur bashkëpunimin midis aktorëve që operojnë në QN
3. Zbatimi i rotacionit në postet e QN si nga ana e nxënësve ashtu edhe mësuesve
4. Duke përmirësuar ligjin ekzistues dhe vendosjen e masave në raste shkeljesh
5. Duke bashkërenduar dhe koordinuar punën me nxënës të tjerë
6. Duke intensifikuar komunikimin dhe shpërndarjen e informacioneve
7. Të rritet ndikimi i fjalës së QN në proceset e vendimarrjes në shkolla

Sado që Qeveria e Nxënësve është një strukturë që garanton përfshirjen e të rinjve në mënyrë aktive në proceset e vendimarrjes, ajo kurrësesi nuk është një strukturë që mund të funksionojë e vetme. Për këtë arsye ka nevojë për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet aktorëve, një çështje që është vënë në

dukjË edhe nga vetË tË rinjtË. NË lidhje me mbËshtetjen qË kËrkon Qeveria e NxËnËsve nga strukturat e ndryshme nË shkollË apo nga institucionet nË mËnyrË qË ajo tË mirËfunksionojË tË rinjtË sygjerojnË:

1. MbËshtetje financiare pËr zhvillimin e aktiviteteve dhe eventeve qË ngrenË kapacitetin e tË rinjve
2. Krijimin e kushteve pËr ushtrimin e kompetencave tË QN
3. Fasilitimin e aktiviteteve nga shkolla psh: ofrimi i lejes apo ambjenteve pËr zhvillimin e mbledhjeve dhe aktiviteteve
4. Rritja e motivimit dhe suportit psiko-social nga mËsueset
5. Rritja e transparencËs nË proceset e vendimarrjes nË shkolla
6. Rritja e bashkËpunimit me organizatat e shoqËrisË civile

Sygjerimet e nxËnËsve janË marrË edhe nË lidhje me ligjin e arsimit parauniversitar pËr strukturËn e QeverisË sË NxËnËsve (nivelet 9-vjeçare dhe tË mesme). KËto sygjerime janË ndarË nË tre kategori si mË poshtË:

- Duke iu referuar rolit, detyrave, pËrgjegjËsive, funksionit tË QeverisË sË NxËnËsve

1. Zhvillim i ri kompetencash dhe autonomia administrative
2. Vendosja e kriterëve mË tË forta pËr pËrzgjedhjen e kandidatËve tË rinj si dhe vlerËsim dhe kontroll tË dosjes sË çdo individi.
3. Rotacion nË postËt qË mbahen nga QN dhe gjithËpËrfshirje e tË rinjve
4. TransparencË nË aktivitetet dhe iniciativat qË merr QN
5. Ndarja e roleve, detyrave dhe pËrgjegjËsive me qËllim rritjen e bashkËpunimit
6. Evidentimi dhe pËrzgjedhja e personave unik jo domosdoshmËrisht me rezultate tË larta nË mËsime
7. Krijimi i mundËsive tË rrjetËzimit me shkollat e tjera
8. Nxitja dhe promovimi i ideve kreative
9. TË rritet niveli i pËrgjegjshmerisË sË anËtarËve tË QN

- Duke iu referuar drejtorit të shkollës dhe bashkëpunimit me Qeverinë e Nxënësve

1. Koordinimi i punës dhe aktiviteteve shkollore me punën e QN
2. Rritja e komunikimit me QN dhe aktorët e tjerë si mësuesi coordinator dhe mësues të lëndës
3. Rritja e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj iniciativave të QN
4. Rritja e transparencës në aktivitete që zhvillon shkolla
5. Të krijojë lehtësi veprimi dhe autonomi në vendimarrje të të rinjve
6. Të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë vendimet e QN
7. Të ndajë eksperiencë dhe informacione të vlefshme me nxënësit

- Duke iu referuar mësuesit coordinator

1. Të zbatojë rregulloren dhe lehtësimin e aktiviteteve që zhvillon QN
2. Të bashkëpunojë dhe mbështesë iniciativat e marra nga QN
3. Të sygjerojë dhe të angazhohet në mënyrë aktive në nismat e QN
4. Të suportojë kauzat dhe vendimet e marra nga QN

The image features a white background with several diagonal lines in shades of teal and orange. These lines are arranged in a pattern that suggests movement and growth, with some lines appearing as double or triple lines. The lines are scattered across the page, with a concentration in the bottom half and a few lines extending into the top right corner. The text 'NENTOR 2020' is centered in the middle of the page.

NENTOR 2020